

## Shtojca 11

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (NE PERFUNDIM TE AFATEVE TE ANKIMIMIT )

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Data: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "TOTO-VRION" shpk.

Adresa: Vrion, Bashkia Finiq

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës/ referenca e lotit: REF-95576-02-15-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje karburanti Gaz, Benzin, Diesel për vitin 2024", me fond limit 18.333.333 (tetëmbëdhjetë milionë e trëndë e tridhjetë e tre mijë e treqinde tridhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe kohezgjatje prej lidhjes së kontratës deri me 365 dite.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.9, date 19 Shkurt 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Oparatori Ekonomik "TOTO-VRION" shpk K27113508E

Vlera: 17.925.231 (shtatëmbëdhjetë milion e nentëqinde e njëzetë e pesë mijë e dyqinde tridhjetë e një) lekë pa TVSH .

2. Operatori Ekonomik "BOKOLLO-OIL" shpk L56622501K

Vlere 18.121.918 (tetëmbëdhjetë milion e njëqinde e njëzetë e një mijë e nentëqinde e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Ska

1. "BOKOLLO-OIL" shpk

L56622501K

per arsyet e meposhtme:

Nuk ka paraqitur:

Operatori Ekonomik nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit sepse Operatori ekonomik “BOKOLLO-OIL” shpk, nuk kualifikohet për arsyet si më poshtë vijon: Nuk ploteson pikën 2.3 të Dst është kërkuar : **2.3.1** Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme me vlerë totale 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.** Kjo OE ka paraqitur për përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur Kontraten me nr 500 prot date 25.02.2019 me Objekt “Furnizim me karburant për mjete të Bashkisë Finiq “me vlerë 3.000.000 leke me tvsh.

Kjo OE ka paraqitur për përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur Kontraten me nr 3187/1 prot date 22.11.2018 me Objekt “Blerje karburanti (gazoil, benzin, gaz propan i lëshem) viti 2018” me vlerë 7.200.000 leke me tvsh me afat levrimit deri me 31.12.2018. Ka paraqitur dhe faturen me nr 1 date 17.03.2023 me vlerë 54.600 leke me tvsh.

Kjo OE nuk përmbush këto kriter pas dy objekteve të paraqitura jashtë afatit 3-vjeçar.

Kjo OE nuk e përmbush këto kriter pas punës së ngjashme që duhet të paraqitet duhet të kishte vlerën 7.333.333,2 leke brenda një afati 3-vjeçar nga data e zhvillimit të tenderit.

-Nuk ploteson pikën 2.2 të Dst është **2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vertetim të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas QKB –së ,ne zbatim të ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vertetimin e lëshuar nga Bashkia.

Për plotësimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Bazuar në deklaratën e vetedeklarimit në formularin shtojca nr 8 ju shpreheni se i keni paguar të gjitha detyrimet të taksave dhe tarifave. Nderkoh nga informacioni i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq ju figuroni debitor .

Bazuar në nenin 76 , pika 3, gërma “ë” të LPP-së, Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: Operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomike “TOTO-VRION” shpk me adresë Vrion, Bashkia Finiq, se oferta e paraqitur me Vlera: 17.925.231

(shtatembedhjetemilion e nenteqinde e njezete e pese mije e dyqinde tridhjete e nje)leke pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Finiq, Drejtoria Juridike, Sektori i prokurimeve, me adrese 9716 Finiq, Vlore sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) leke pa THSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Romeo ÇAKULI**